



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 18 shtator 2017  
Nr. ref.:RK 1125/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI03/17**

Parashtrues

**Ahmet Buçaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), AC-I.-16-0125-A0001, të 20 dhjetorit 2016**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ahmet Buçaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Nabërgjan, komuna e Pejës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin AC-I-16-0125-A0001 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) të 20 dhjetorit 2016.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit AC-I.-16-0125-A0001 të 20 dhjetorit 2016.
4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i mundësojë atij që të përfitojë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Hotel Grand", megjithatë, ai nuk thirret asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22, 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 10 janar 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 27 shkurt 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Gresa Caka Nimani.
8. Më 2 maj 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta plotësojë formularin e kërkesës, si dhe të sigurojë të gjitha dokumentet relevante siç kërkohet me nenin 22.4 të Ligjit dhe rregullin 29 të Rregullores së punës.
9. Më 18 maj 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentet përkatëse siç kërkohet me nenin 22.4 të Ligjit dhe rregullin 29 të Rregullores së punës.
10. Më 25 maj 2017, një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.
11. Më 3 korrik 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), duke kërkuar përfshirjen në listën e saj përfundimtare për të fituar 20 për qind të të ardhurave nga privatizimi i hotelit "Grand" në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se ai kishte punuar në këtë NSH për 28 vjet dhe se marrëdhënia e tij e punës ishte ndërprerë për shkak të "masave të përkohshme serbe".
13. Më 20 janar 2016, Kolegji i Specializuar i Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme, Kolegji i Specializuar) me Aktvendimin C-II-13-0447, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme.
14. Më 9 mars 2016, parashtruesi i kërkesës, për të njëjtën çështje, parashtroi ankesë të re në Kolegjin e Specializuar, të regjistruar me nr. C-II-16-0033. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër këtij vendimi i cili ishte regjistruar për Kolegjin e Apelit me nr. AC-I-16-0011..
15. Më 24 maj 2016, Kolegji i Specializuar i Gjykatës Supreme nxori Aktvendimin C-II-0033-C0001, me të cilin ishte refuzuar ankesa si e papranueshme në bazë të "res iudicata" si dhe në bazë të "lis pendens".
16. Arsyetimi i vendimit të lartpërmendur mund të përmblihet si në vijim: "Ne arsyetimin e aktvendimit të ankimuar thuhet se Kolegji i Specializuar me Aktvendimin C-II.-13-0447 të datës 20 janar 2016, ankesa e ankuesit ishte hedhur si e papranueshme, ndaj të cilit aktvendim ankuesi kishte parashtruar ankesë ndërsa kjo ankese është regjistruar për Kolegjin e Apelit me nr. AC-I.-16-0011 . Ankuesi për të njëjtën çështje ka ushtruar ankesë më 09.03.2016 dhe lënda ka marrë nr. C-II.-16-0033. Për shkak se dosja e lëndës C-II.-13-0447 është më e vjetër se lënda C-II.-16-0033, kjo e dyta duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, sepse lënda konsiderohet lis pendens. Meqenëse lënda C-II-13-0447 (me e vjetër) tashme është vendosur, hidhet poshtë ankesa si e papranueshme në lëndën C-II .-16-0033, pasi që konsiderohet res iudicata".
17. Parashtruesi parashtroi "kërkesë" kundër këtij vendimi, i cili është regjistruar si ankesa me nr. AC-I-16-0125-A0001. Në këtë parashtrësë, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Kolegji i Apelit që t'ia njohë të drejtën e tij në 20 për qind të të ardhurave nga shitja e NSH-së, në të cilën ai pretendonte se kishte punuar për më shumë se 28 vjet.
18. Më 20 dhjetor 2016, Kolegji i Apelit nxori Aktvendimin AC-I-16-0125-A0001:
  1. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.
  2. Vërtetohet Aktvendimi C-II-16-0033-C0001 i Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK, i 24 majit 2016,
19. Vendimi i lartcekur i Kolegjit të Apelit mund të përmblihet si më poshtë: "Kolegji i Specializuar e kishte hedhur ankesën e ankuesit si të papranueshme

për shkak të dy bazave juridike- res iudicata dhe lis pendens. Me këtë vendim të Kolegjit të Specializuar pajtohet tërësisht edhe Kolegji i Apelit, duke e refuzuar parashtrësën (ankesën) e ankuesit si të pabazuar. Me Aktvendimin C-11.13-0447 të datës 20 janar 2016, Kolegji i Specializuar e kishte hedhur ankesën e ankuesit si të papranueshme, sepse kjo çështje ishte gjykuar nga Kolegji i Specializuar, ndërsa është ne pritje të zgjidhjes sipas ankesës për Kolegjin e Apelit me shifrën AC-I.-16-0011 . Kolegji i Specializuar me të drejtë ka vendosur në këtë mënyrë, sepse dosja e lëndës C 11.-13-0447 është me e vjetër se lënda C-II.-16-0033, e cila pret për zgjidhje në Kolegjin e Apelit. Për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon parashtrësën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërteton aktvendimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

20. Parashtruesi i kërkesës nuk pretendon shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti, megjithatë, ai, ndër të tjera, thekson se: “Në vitin 1999, kur përfundoi lufta, Drejtori i ndërmarrjes së hotelerisë dhe turizmit “Hoteli Grand” - tani Hoteli “Iliria”, ZÇ i ka kthyer të gjithë punëtorët në punë. Edhe pse kam kërkuar, ai nuk më pranoi mua. Unë mbeta pa asgjë, prandaj me gojë dhe zyrtarisht kam kërkuar që të më paguhet 20% e të ardhurave, si dhe një pjesë nga shitja e objekteve, por ai nuk refuzoi të më paguajë. Kam kontribuar për 28 vjet. Ai i ka paguar të gjithë të punësuarit përveç meje, prandaj, ishte i detyruar që t’i drejtohem AKM-së, AKP, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe tani ju drejtohem juve - Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në mënyrë që t’i fitojë të drejtat e mia si të gjithë kolegët e mi”.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë**

21. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:  

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
23. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

#### *Neni 48*

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

24. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 (2) (a) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*

*[...]”.*

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të dorëzuar kërkesën, se ai ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës si dhe kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit.
26. Gjykata duhet gjithashtu të vërtetojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka specifikuar dhe dëshmuar pretendimet e paraqitura në pajtim me nenin 48 të Ligjit.
27. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës është se kjo Gjykatë duhet t'i mundësojë atij *“që të përfitojë një pjesë nga 20% i të ardhurave nga privatizimi i NSH “Hotel Grand” tani “Iliria”.*
28. Gjykata po ashtu thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
29. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I). Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
30. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e standardeve kushtetuese gjatë procedurave gjyqësore në gjykatat e rregullta, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi 6 i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* shih



rastin KI86/11, parashtues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012 dhe rastin nr. KI86/16, parashtues i kërkesës, “*BENI*” *Ndërmarrja Tregtare*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2016).

31. Gjykata thekson se detyrë e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih: rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
32. Në dritën e shqyrtimeve të mësipërme, Gjykata vëren që parashtuesi i kërkesës ka pasur dobi nga procedurat kundërshtuese; ka mundur që në faza të ndryshme të paraqesë argumente dhe prova që i konsideronte relevante për rastin e tij; ka pasur mundësi që në mënyrë efektive të kontestonte argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtuese; që të gjitha argumentet e tij, që në pikëpamje objektive, ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij, ishin dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat; që arsyet ligjore dhe faktike për vendimet e kontestuara ishin shqyrtuar në hollësi; dhe që, në pajtim me këtë, procedurat në tërësi ishin të drejta (Shih: rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Kërkesa nr. 30544/96, [DHM], Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
33. Duhet marrë parasysh, meqë ky është një burim i shpeshtë i keqkuptimeve nga ana e parashtuesve të kërkesës, që “drejtësia” e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës nuk është drejtësi “përmbajtjesore” (një koncept që është pjesërisht ligjor, pjesërisht etik dhe mund të aplikohet vetëm nga gjyqtari i çështjes), por është drejtësi “procedurale”. Në aspektin praktik kjo kuptohet si procedurë e kundërshtimit në të cilën parashtimet dëgjohen nga palët dhe në të cilën palët janë të barabarta para gjykatës (Shih rastin *Star Cate - Epilekta Gevmata dhe të tjerët kundër Greqisë*, Aplikacioni Nr. 54111/07, GJEDNJ, Vendimi i 6 korrikut 2010).
34. Fakti se parashtuesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë (Shih: rastin nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).
35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa e parashtuesit për t’i mundësuar atij që të përfitojë një pjesë të të ardhurave që rrjedhin nga privatizimi i NSH-së “Hotel Grand” nuk është një pretendim që ngre çështje kushtetuese.
36. Për këtë arsye, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës vetëm numëron dhe në përgjithësi përshkruan përmbajtjen e dispozitave kushtetuese, duke mos dëshmuar saktësisht se si ato dispozita ishin shkelur në rastin e tij, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
37. Prandaj, kërkesa pas vlerësimit të tërësishëm të të gjitha pretendimeve, duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, siç përcaktohet me nenin

113 (7) të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (2) (a) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe të rregullin 36 (2) (a) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2017, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Snezhana Botusharova



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi